

Studentë nga Universiteti i Tiranës dhe Korçës vizitojnë Kontrollin e Lartë të Shtetit në kuadër të aktivitetit “Java e hapur”

Në kuadër të 99-vjetorit të themelimit si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Shqipërisë, si dhe mbështetur në standardin ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 12, “*Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit - të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve*”, Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga data 20 deri më 24 maj 2024 organizoi aktivitetin “Java e hapur”.

Studentë nga disa universitete publike u ftuan për të zhvilluar vizita dhe takime informuese në ambientet e Kontrollit të Lartë i Shtetit (KLSH). Një grup studentësh ekselentë që ndjekin studimet e ciklit të dytë “Master Shkencor” në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, zhvilluan një vizitë në Kontrollin e Lartë të Shtetit.



Studentët u njohën me historikun e Kontrollit të Lartë të Shtetit duke parë nga afër ekspozimet e dokumenteve historike të institucionit. Në vijim, u zhvillua një bashkëbisedim me studentët për promovimin e rolit dhe veprimtarisë së KLSH-së, si funksionon institucioni, auditimet që kryhen, bashkëpunimet etj.



Si profesionistë të ardhshëm në fushën e financës dhe kontabilitetit, studentët shfaqën interes për të kryer praktika punësimi në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

KLSH ka mirëpritur edhe studentë nga Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin “Fan Noli” Korçë, për t’i informuar mbi aktivitetin e institucionit.



Bazuar edhe në Strategjinë e Komunikimit, bashkëpunimi me universitetet për njohjen dhe promovimin e rolit dhe punës së KLSH-së tek profesionistët e rinj është një nga objektivat e institucionit. Në këtë kuadër, KLSH gjatë vitit 2023 ka zhvilluar takime në disa universitete publike për realizimin e anlizave vjetore, hartimin e planit të auditimeve 2024.